

Projekti PPSE (SwissContact)

Projekti Promoting Private Sector Employment – PPSE implementohet nga SwissContact. Projekti ka synon rritjen e produktivitetit dhe të gjenerojë të hyra shtesë dhe punësim nga NVM-të në sektorët e përzgjedhur, duke u mundësuar kështu ofruesve të shërbimeve dhe inputeve që të zhvillojnë produkte të avancuara dhe të qëndrueshme (mallra dhe shërbime) dhe praktika të prodhimit. Fillimisht, projekti fokusohet në dy sektorë kryesorë: sektori i përpunimit të ushqimit dhe sektori i turizmit, ndërsa sektori i prodhimit do të përzgjidhet brenda gjashtë muajve të parë të fazës së implementimit, ai i prodhimit të tekstit apo përpunimit të drurit.

Fondi i mundësive është mekanizëm grantesh në përkrahje të krijimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të punësimit në sektorin privat për të rinjtë. Do t'i përkrah intervenimet të cilat testojnë idetë e reja, inovative dhe të rrezikshme, njëherit ofron mundësinë për ndryshim në treg duke çuar në rritje të ndjeshme të sektorit privat dhe krijim premtues të punësimit.

Për informata të më tutjeshme: www.ppsekosovo.org